

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj kryetar dhe Lumni Sallauka e Burim Shala anëtarë, në çështjen kontestimore të paditëses I.J. nga fshati, Komuna e Novobërdës, të cilën e përfaqëson Z.I. avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Kompania e Sigurimeve "Insig" nga Prishtina, për shkak të kompensimit të dëmit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.977/2010 të datës 24.03.2014, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 17.10.2018 mori këtë:

AKT GJYKIM

REFUZOHET si e pathemeltë ankesa e të paditurës Kompania e Sigurimeve "Insig" nga Prishtina, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.977/2010 i datës 24.03.2014, VËRTETOHET.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit miratohet si pjesërisht e bazuar kërkesëpadia e paditëses I.J. nga fshati Llabjan, Komuna e Novobërdës, në pikë II., të dispozitivit prishet marrëveshja jashtëgjyqësore e lidhur me datë 31.03.2003, e lidhur në mes të paditurës Kompania e Sigurimeve "Insig" nga Prishtina dhe përfaqësuesit të paditëses për shkak të dëmtimit përtej masës, në pikën III., të dispozitivit detyrohet e paditura Kompania e Sigurimeve "Insig" nga Prishtina, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit jo material, t'ia paguaj shumat si vijon: për dhimbje fizike shumë prej 3000 €, për frikën e pësuar shumë prej 1500 €, për shëmtim trupor shumë prej 3500 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor shumë prej 12000 €, ashtu që nga shuma e tërësishme që arrin vlerën prej 20.000 €, zbritet shuma prej 5.552 €, të cilën e paditura më parë ja ka paguar paditëses në emër të kompensimit të dëmit, tani duhet që paditëses t'ia paguaj shumë prej 14.478 €, të gjitha këto me kamatë siç i paguan banka, për mjetet pa destinim të caktuar të afatizuara mbi 12 muaj, duke filluar nga data e gjykimit e gjerë në pagesën përfundimtare në afatin prej 15 ditësh nga dita e marrjes së aktgjykimit, në pikën IV., të dispozitivit refuzohet si e pa themeltë pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses mbi shumat e aprovuara, në pikën V., të dispozitivit obligohet e paditura që në emër të shpenzimeve të procedurës t'ia paguaj shumë prej 1352 €, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit e nën kërcënim të përmbarimit.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes

faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës ta aprovoj ankesën, ta ndryshoj vendimin gjyqësorë ose lëndën ta kthej në rigjykim.

Gjykata e Apelit e Kosovës, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194 të LPK, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ka paraqitur padi pranë Gjykatës Komunale në Prishtinë lidhur me shpërblimin e dëmit të pësuar në aksidentin e komunikacionit të datës 25.09.2002 në rrugën Ferizaj – Gjilan, në qendër të fshatit Partesh, ku paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore, për çka ka kërkon nga gjykata që ta detyroj të paditurën për kompensimin e dëmit të pësuar.

Gjykata Komunale tani Gjykata Themelore e Gjilanit me aktvendimin C.nr.266/2003 të datës 23.05.2003, shpallet jo kompetente në pikëpamje territoriale dhe më datë 19.06.2003, lëndën ia dërgon në procedim të mëtejshëm Gjykatës Komunale – tani Themelore në Prishtinë, e cila të njëjtën e regjistron me numër të procedimit C.nr.1290/2003.

Gjykata Komunale e Prishtinës, bazuar në parashtresën e të autorizuarit të paditëses të datës 26.05.2003, të cilën ia kishte dërguar Gjykatës Komunale në Gjilan, merr aktvendimin C.nr.1290/2003 të datës 17.05.2004, me të cilin konstaton se padia e paditëses është tërhequr pasi që ndërgjyqësit kishin arritur marrëveshje jashtë gjyqësore. Kjo gjykatë gjithashtu më datën 26.05.2004 nxjerrë aktvendimin C.nr.1290/2003 me të cilin e shfuqizon aktvendimin e lartcekur C.nr.1290/2003 të datës 17.05.2004, me arsyetim se avokati V.P. nga Bujanovci, nuk kishte autorizim të rregullt për tërheqje të padisë lidhur me këtë çështje juridike. Më tutje në këtë çështje pas mbajtjes së disa seancave me radhë dhe precizimit të padisë të dorëzuar në këtë gjykatë më datë 05.10.2004, nga i autorizuari i paditëses av. Z.I. Gjykata Komunale në Prishtinë, merr aktgjykimin C.nr.1290/2003 të datës 08.10.2004, me të cilin detyron të paditurën që paditëses t'i paguaj shumën 4.448,00 €, me kamatë ligjore duke filluar prej 25.09.2003, si dhe shpenzimet e procedurës në shumë prej 705,00 €. Në faqen 3 të këtij aktgjykimi, paragrafi i parafundit që i përket arsyetimit shihet se gjykata kishte caktuar për pagesë shumën e tërësishme prej 10.000,00 €, por që nga kjo shumë kishte zbritur shumën prej 5.552,00 €, të cilën e paditura ia kishte paguar paditëses, kështu që kishin mbetur për pagesë siç u cek shuma prej 4.448,00 €. Kundër këtij aktgjykimi e paditura në afat ligjor kishte ushtruar ankesë siç shkruan për shkak të shkeljeve nga të gjitha bazat ligjore. Gjykata e Qarkut në Prishtinë si gjykatë e shkallës së dytë sipas ankesës së cekur me aktvendimin Ac.nr.388/2005 të datës 06.12.2007, prish aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Prishtinë C.nr.1290/2003 të datës 18.10.2004, dhe lënda kthehet në rigjykim për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që qëndrojnë në atë se dispozitivi i aktgjykit ishe në kundërshtim me arsyetimin dhe për arsye të mos përmbajtës së fakteve vendimtare dhe arsyeve kundërtënëse dhe të paqarta, mos konkretizimit dhe saktësisimit të llojeve të dëmit material dhe jo material dhe mos konkretizimit të lartësisë së kamatë - vonesës. Gjykata Komunale tani Themelore në Prishtinë në rigjykim me aktgjykim C.nr.2915/2007 të datës

19.06.2009, pjesërisht aprovon kërkesëpadinë e paditëses duke obliguar të paditurën që paditëses në emër të gjitha formave të dëmit t'ia kompensoj shumën prej 22.150,00 €, të cilës duhet ti zbritet shuma që ishte paguar paditëses prej 5.552,00 €, e që nuk ishte kontestuese në mes palëve, kështu që caktoj për pagesë shumën prej 16.598,00 €, dhe shpenzimet procedurale në shumë prej 945.60 €. Edhe ndaj këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor kishte ushtruar ankesë nga të gjitha bazat ligjore që kanë të bëjnë me mjetin e rregullt juridik. Gjykata e Qarkut – tani e Apelit në Prishtinë, me aktvendimin Ac.nr.1329/2009 të datës 20.04.2010 e prishi edhe aktgjykimin C.nr.2915/2007 të datës 19.06.2009, duke ia kthyer gjykatës së shkallës së parë çështjen në rigjykim.

Gjykata e shkallës së parë në rivendosje për herë të tretë, duke u bazuar në vërejtjet dhe sugjerimet e gjykatës së shkallës së dytë ka vazhduar me mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor ku i autorizuar i paditëses në shqyrtimet e mbajtura në këtë gjykatë dhe në parashtrësën për precizim të kërkesëpadisë, dorëzuar gjykatës më datë 04.03.2014, në seancën përfundimtare ka deklaruar se se mbetet në tërësi pranë theksimeve të mëparshme dhe precizimit të fundit të kërkesëpadisë ku janë dhënë të gjitha arsyet lidhur me të gjitha kategoritë e dëmit si dhe lartësitë e shumave që do duhej të paguheshin për lëndimet e pësuar të paditëses. Pala paditëse nuk i ka kontestuar faktin se se e paditura i ka paguar paditëses 5.552 €, sipas një marrëveshje jashtë gjyqësore në mes tyre, por meqë sipas ekspertizave mjekësore dhe provave tjera të nxjerra konsideron se pala paditëses është vënë në lajthim me shumën e paguar, duke marrë parasysh dispozitat e LMD-së, që kanë të bëjnë me dëmtimin përtej gjysmës së vlerës, ka kërkuar që marrëveshja e lidhur në mes të dy palëve të priset, kurse kërkesëpadia me shumën e kërkuara të aprovohet së bashku me kamatën të llogaritur nga seanca e sotme mbajtur me datë 24.03.2014. Përfaqësuesja e të paditurës e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses, pasi që e paditura konsideron se e ka kryer obligimin ndaj paditëses në mënyrë të drejtë, në bazë të marrëveshjes së datës 31.03.2003 e cila është lidhur me vullnet të lirë të palëve, pa mashtrim dhe lajthitje. Përfaqësuesja e të paditurës ndër të tjera ka theksuar se i autorizuar i paditëses ka qenë profesionist dhe se i njëjti ka ditur saktë vlerën e kompensimit për dëmin e pësuar nga pala paditëse.

Gjykata e shkallës së parë për vërtetimin e gjendjes faktike ka bërë administrimin e provave si: fletë lëshimin e Qendrës Shëndetësore në Vranjë të datës 25.10.2002, raportit të shkruar të mjekut ortoped të datës 27.02.2002, certifikatën e lindjes nr.03-3200-3156 të datës 26.02.2003 në emër të I.J., procesverbali i datës 28.04.2002, dëftesa e MEB Bankës nga data 31.03.2002 e cila e mban shumën prej 5.552 €, urdhëresa për pagesën e dëmit nga e paditura “Insig” nr.156/01/03 nga 17.03.2003, autorizimi i paditëses dhënë V.P., marrëveshja interne në mes të autorizuarit të I.J. si e dëmtuar dhe të paditurës Kompania e Sigurimeve “Insig”, aktvendimi i të paditurës “Insig” nr.007/2003 datë 28.01.2003, kërkesa e të dëmtuarës – paditëses I.J. për kompensim të dëmit datë 03.03.2003, mendimi i ekspertit të ortopedisë Dr. M.D., datë 18.10.2004 dhe ekspertit të psikiatrisë Dr.N.M. të datës 06.02.2004, dhe nxjerrë vendimin me të cilin kërkesëpadia e paditëses është miratuar pjesërisht duke vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 , pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Neni 31par.1 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike” [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm].

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes gjyqësore në rast të shkeljes ose mohimit të ndonjë të drejte të garantuar me këtë Kushtetutë ose me ligj, si dhe të drejtën në mjete efektive ligjore nëse konstatohet se një e drejtë e tillë është shkelur”.

Neni 13 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut: “Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

Neni 190 i LMD-së: “Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkaktit të dëmit, do të gjykojë kompensimin në një shumë që nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarit të sjellet atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues ose ometim”.

Neni 319.1 i LPK: “Secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Nisur nga gjendja e vërtetuar faktike kolegji i Gjykatës së Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të të paditurës lidhur me atë se aktgjykimi i atakuar është rrjedhojë e vërtetimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike, janë të pa themelta dhe vlerëson se gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të provave të administruara të ofruara nga palët ndërgjyqës, ka marrë aktgjykimin i cili sipas vlerësimit të kolegjit të Gjykatës së Apelit është i drejtë dhe i ligjshëm dhe se gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye konkrete edhe për faktet vendimtare duke dhënë shpjegimet dhe arsyet adekuate për një vendosje të këtillë bazuar në dispozitat përkatëse ligjore që i referohen kësaj çështje kontestuese.

Vlerësimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të ligjshëm e miraton në tërësi edhe ky kolegji, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe se në rastin konkret është bërë zbatimi i të drejtës materiale në mënyrë të drejtë, e për të cilat shkaqe gjykata e shkallës së dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare. Kolegji vlerëson se bazuar në të gjitha këto që u parashtruan më lartë, rezulton se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të parashtruara nga ana e palës së paditur me ankesë.

Kolegji gjenë se paditësja bazuar në nenin 31 dhe 54 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neneve 6 dhe 13 të Konventës ka të drejtë që të kërkoj mbrojtje ligjore para gjykatës dhe që ti garantohet një proces i drejtë ligjor sipas një procedure të rregullt e që si rezultat i zhvillimit të një procedure të tillë të nxirret edhe një vendim i drejtë dhe i mbështetur në ligj. Kolegji i shqyrtoi pretendimet ankimore të të paditurës në lidhje me kompensimin e dëmit për të dëmtuarën – këtu paditësen, i cili rrjedh nga Ujdia Jashtëgjyqësore dhe se për këtë arsye paditësja nuk ka të drejtë të kërkoj me padi shpërbllim tjetër, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pa bazuara. Kjo për faktin se në nenin 190 të LMD-së është parashikuar që : *"Gjykata, duke marrë parasysh edhe rrethanat që kanë lindur pas shkaktimit të dëmit, do të gjykojë kompensimin në një shumë që nevojitet që gjendja materiale e të dëmtuarit të sjellet atje ku do të ishte po të mos kishte veprim dëmtues ose ometim"*. Në rastin konkret kolegji gjenë se shumta e kompensuar me Ujdinë Jashtëgjyqësore prej 5.552,00 €, nuk përfaqëson kompensim adekuat për dëmin ashtu siç e ka përcaktuar neni 190 i LMD-së. Mbi këtë bazë kolegji vlerëson se ekziston detyrimi i të paditurës që të bëjë kompensimin e pjesës së mbetur pa u kompensuar dhe se shumata e gjykuara si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë përfaqësojnë satisfaksion për paditësen dhe do të ndikojnë që gjendja materiale e paditëses të sjellet atje ku ishte para se të shkaktohej dëmi i pësuar nga ajo.

Kolegji përfundimisht gjenë se e paditura nuk ka arritur të bëjë edhe argumentimin e pretendimeve të parashtruara me ankesë, andaj të njëjtat kanë mbetur në nivel të pretendimeve. Bazuar në nenin 319.1 të LPK-së, secila nga palët ndërgjyqës ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta. Kolegji vlerëson se pala e paditur në procedurën e zhvilluar nuk ka arritur të bëjë një gjë të tillë, andaj edhe ankesa e parashtruar për këtë çështje, është vlerësuar si e pa themeltë dhe për këtë gjë edhe është refuzuar si e pa bazuar.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 195 par.1 pika d) të LPK-së, është vendosur si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.4793/2014, me datë 17.10.2018.

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj, d.v.